




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 10.05.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **02.05.2023**, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik “ Item EL SH.P.K. & N.N.T. Korabi ”** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“ Rregullimi i Trotuarit dhe ndriqimit Haxhaj-Demiraj ” me nr. të prokurimit 651-23-1264-5-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 017 521** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** - kërkesa për ri-shqyrtim e **Grup i Operatorëve Ekonomik “ Item EL SH.P.K. & N.N.T. Korabi ”**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“ Rregullimi i Trotuarit dhe ndriqimit Haxhaj-Demiraj ” me nr. të prokurimit 651-23-1264-5-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 017 521** e dt. **02.05.2023** kundër *Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 25.04.2023* të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
2. **AK - Komuna e Gjilanit Vazhdon sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 25.04.2023.**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik “ Item EL SH.P.K. & N.N.T. Korabi ”, me datë **02.05.2023**, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“ Rregullimi i Trotuarit dhe ndriqimit Haxhaj-Demiraj ” me nr. të prokurimit 651-23-1264-5-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 017 521**

Autoriteti Kontraktues me datë **05.05.2023** ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sipas pretendimit tuaj nr. I – se AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit në përgjithësi, nuk ka luajtur rol aktiv për tu siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe efektive. Neni 1 shumë qartë e thotë se:

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Kjo nuk është respektuar aspak në rastin konkret sepse OE që AK e ka shpallur fitues e ka çmimin më të lartë se ne dhe dyshojmë se nuk i ka pasur të gjitha dëshmitë në rregull me vet faktin që nuk na është lejuar të kemi qasje në tenderin e tijë.

Nga kjo shihet se AK në mënyrë jo transparente po tenton të shpërblej me kontratë një OE që dyshojmë se është i papërgjegjshëm ndërsa na ka eliminuar neve si tenderues me çmim më të ulët në krahasim me të. AK na ka eliminuar me arsyetime të pa bazuara për dëshmi që nuk i ka shikuar fare si dhe për dëshmi që ka mundur edhe të na kërkoj sqarime sipas nenit 59.4 dhe 72 të LPP-së.

Bazuar në këtë që e thamë më lartë, konstatohet se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 të LPP-së duke mos vlerësuar tenderët në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me kërkesat e ligjit.

Përgjigjia e AK lidhur me pretendim nr. 1 është se:

Pretendimi i juaj nuk qëndron pasi që Autoriteti Kontraktues (AK) – konstaton se ka vepruar dhe vlerësuar gjitha ofertat ka vepruarë në mënyrë transparente dhe harmoni me Nenin 1 të LPP-së.

Pretendimet e juaja se dyshoni se OE i rekomanduar që të shpërblehet me kontratë nuk i ka pasur të gjitha dëshmitë në rregull, AK ka konstatuar se kjo nuk qëndron pasi që ka vërtetuar se OE i rekomanduar që të shpërblehet me kontratë, ka ofruar ofertën e tij në përgjegjshme në harmoni me kërkesat e DT dhe Njoftimit për Kontratë të AK.

AK ka vepruar në harmoni me Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi - ka trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminime dhe ka vepruarë në mënyrë transparente.

Oferta e juaj është eliminuar sipas arsyeve të cekura edhe në letrën standarte pasi që nuk ka qenë e përgjegjshme sipas kërkesave të DT dhe Njoftimit për Kontratë përkundër që keni paraqitur çmimin më të ultë.

Kriter i dhënies së kontratës sipas DT dhe Njoftimit për Kontratë ka qenë: *Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.*

Sipas pretendimit tuaj nr. II se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit në mënyrë të barabartë. E themi këtë sepse neve na ka eliminuar me arsyetim se gjoja na mungojnë dëshmitë për pajisjet e kërkuara edhe pse i ka pasur të gjitha ne tenderin tonë si dhe për disa të dhëna mbi stafin të cilat ka mundur të i sqaroj përmes nenit 59.4 dhe 72 të LPP-së. Diskriminimi tjetër na është bërë me rastin e mos dhënies qasje në tenderin e OE që e ka shpallur fitues edhe pse i njëjti ka kërkuar që vetëm kapaciteti financiar dhe teknik të mbetet sekret afarist. Kjo është sjellje komplet në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së i cili detyrimisht kërkon trajtim të barabartë të

tenderuesve. AK shihet se e ka favorizuar OE që e ka shpallur fitues ndërsa neve na ka diskriminuar duke mos na kërkuar sqarime për tenderin tonë edhe pse ka pasur paqartësi dhe këtë ja lejon plotësisht LPP-ja. Bazuar në këtë lirisht mund të themi se AK gjatë procesit të vlerësimit ka vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe në kundërshtim edhe me parimet bazë të prokurimit mbi trajtimin e drejtë dhe të barabartë të tenderuesve.

Përgjigjia e AK lidhur me pretendim nr. 2 është se:

Pretendimi i juaj nuk qëndron pasi që Autoriteti Kontraktues (AK) – konstaton se ka vepruar në harmoni me Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi - ka trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminime dhe ka vepruarë në mënyrë transparente.

Sa i përket pretendimit se jeni diskriminuar me rastin e mos dhënies qasje në tenderin e OE që e ka shpallur fitues. AK ju ka lejuar qasjen në dokumentet zyrtare përveç atyre që OE i rekonaduar që të shpërblehet me kontratë i ka cilësuar si sekrete afariste.

Sipas pretendimit tuaj nr. III - se AK ka shkelur nenin 10 dhe 11 të LPP-së pasi që nuk na ka dhënë qasje në tenderin e OE që ishte shpallur fitues edhe përkundër kërkesës të parashtuar nga ne. Mos lejjimin e qasjes në dosjen e tenderit të OE fitues AK e arsyeton me kërkesën e OE që të mbeten sekret të dhënat mbi kërkesat financiare dhe ato teknike. Këtu AK vepron plotësisht në kundërshtim me nenin 10 dhe 11 të LPP-së sepse nuk na jep qasje as në pjesët tjera të tenderit që OE nuk kishte kërkuar të jenë sekret afarist dhe në kundërshtim me nenin 11.4 të LPP-së ku nuk e përgatit fare versionin e pastruar të dokumente që ne të kemi mundësi të i shohim sipas versionit të pastruar. Ja si e detyron AK-në për të vepruar në rastet e tilla neni 11.4 i LPP-së:

Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e “pastruar” të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkëngjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste.

Vet fakti që OE në fjalë po fsheh diçka që realisht është publike pasi që dokumentet mbi kërkesat financiare si dhe dëshmitë mbi pajisjet teknike nuk janë dokumente që mund të cilësohen si sekret afarist sepse gjinden edhe në institucione tjera, dyshohet se ka ndonjë mangësi tek to që nuk po donë që ta shohim ne. Arsyetimi i OE se pse kërkon të mbeten sekret afarist dëshmitë e tilla, ishte frika se mos ne do të i përdorim dokumentet e tilla si dëshmi në tenderë tjerë e që për neve është e jashtëligjshme dhe e pa arsyeshme. Pavarësisht kësaj, AK ka mundur të paktën të na i lejoj vetëm në shikim vizual pa na i dhënë si kopje elektronike apo fizike. Përpos kësaj, mos dhënia qasje nga ana e AK-së në pjesën tjetër të tenderit që OE nuk e ka bërë sekret afarist na bënë të dyshojmë se edhe AK ka vërejtur ndonjë shkelje ligjore apo ndonjë mangësi në këto dëshmi se ndryshe nuk do na e ndalonte të shohim si psh. deklaratën nën betim apo certifikatën e biznesit. Kjo është komplet sjellje e kundërligjshme që tregon se AK ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 10 dhe 11 të LPP-së.

Pasi që pretendimi është i ngjajshëm me pretendimin e 2, Vlen përgjigjia e njejt edhe për pretendimin nr. 3.

Sipas pretendimit tuaj nr. IV. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka aplikuar drejtë kërkesat e përcaktuara paraprakisht në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Pika 4 e këtij neni thotë se:

Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Përpos kësaj ky nen e thotë edhe këtë që:

Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Ne konsiderojmë se ky nen është shkelur me rastin e vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve e posaqërisht të tenderit tonë ku jemi eliminuar me arsyetime të pabazuara dhe me arsyetime për mungesë të dokumenteve që AK ka mundur të i sqaroj duke aplikuar nenin 59.4 dhe nenin 72 të LPP-së.

Ne jemi eliminuar me arsyetimin se na mungojnë dëshmit për paisjet: **eskavator, cilindër dhe rul ngjeshës**. Kjo nuk qëndron aspak pasi që dëshmitë e tilla ishin të dorëzuara në tenderin tonë.

Edhe sa i përket arsyetimit se Inxhinieri i Ndërtimtarisë Konstruktive nuk është Menaxher i Projektit po Udhëheqës i Punishtes nuk qëndron sepse pozitën e Udhëheqësit të Punishtes e mban në kompani ndërsa për kontratën e tillë është paraqitur që të i krye punët e Menaxherit të Projektit. Në dosje të tenderit ishte kërkuar vetëm që Inxhinier i Ndërtimtarisë Konstruktive do të jetë Menaxher i Projektit por nuk ishte kërkuar askund ndonjë përcaktim apo vendim i posaçëm për këtë çështje. Me vet faktin që është paraqitur me të gjitha dëshmitë e kërkuara tregon se kërkesa është e plotësuar. Po që se AK ka pasur ndonjë paqartësi, ka mundur të na sqaroj përmes formës ligjore të lejuar pasi që këtë kërkon edhe neni 59.4 dhe neni 72 i LPP-së. Arsyetimi tjetër gjoja për mungesë të Inxhinierit të Gjeodezisë është i pa bazuar sepse AK ka mundur të na sqaroj pasi që dëshmitë për këtë çështje siç është diploma e fakultetit janë dëshmi objektivist të verifikueshme dhe nuk ndodhë asnjë ndryshim substancial nëse sqarohen gjatë procesit të vlerësimit. Kjo do të ishte në përputhje të plotë me nenin 59.4 të LPP-së dhe me nenin 72 të LPP-së,

Përgjigjia e AK lidhur me pretendim nr. IV është se:

Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 59 të LPP-së, ka bërë ekzaminim, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, dhe sipas kritereve të përcaktuara në FDT dhe Njoftimin për kontratë në harmoni me Nenin 60 Kriteret për Dhënie të Kontratës ka shpërblyer me kontratë publike operatorin ekonomik që ka dorëzuar: Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Ndërsa sa i përket arsyetimit rreth Inxhinierit të Ndërtimtarisë Konstruktive, Menaxherit të Projektit, Udhëheqësit të Punishtes, gjeodetit.

AK ka vërtetuar se në ofertën tuaj keni dorëzuar:

Sipas Listës së stafit Bekim Mustafa, Inxhinier i Ndërtimtarisë Konstruktive ka pozitë të Udhëheqësit të punishtes, e jo të Menaxherit siç është kërkuar në aktivitetin në fjalë në DT.

Sipas listës së stafit mungon edhe Inxhinieri i Gjeodezisë si dhe nuk ofruar asnjë dëshmi.

Ndërsa kërkesë e AK ka qenë sipas DT dhe Njoftimit për Kontratë:

Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pasi që sipas DT dhe Njoftimit për Kontratë:

Kërkesa 2 OE-ik duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon :

Një (1) Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë ose master i diplomuar (menaxher i projektit) – drejtimi konstruktiv me me se paku 2 vite përvojë pune pas diplomimit ;

Një (1) Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë ose master i diplomuar apo bachelor– drejtimi hidro, me me se paku 2 vite përvojë pune pas diplomimit ;

Një (1) inxhinier I diplomuar ose master apo bachelor drejtimi Elektroteknikë me më se paku dy vite përvojë pune pas diplomimit apo bachelor i diplomuar ;

Një (1) inxhinier I diplomuar i gjeodezisë ose master i diplomuar me me se paku dy vite përvojë pune pas diplomimit apo bachelor i diplomuar i gjeodezisë me me se paku 2 vite përvojë pune pas diplomimit .

Dëshmia 2 CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.

Dhe për bachelorin e gjeodezis kërkohet që të dorëzohet edhe licence valide.

Grupi i juaj i Operatorve Ekonomik Item EL SH.P.K.;N.N.T.Korabi . Rr.Burim Vitia 10000,Prishtinë është i papërgjegjshëm pasi që nuk e përmbush kërkesën e AK sa i përketë Aneksi nr.7 sepse Në Listën e dorëzuar nga ana juaj mungon mekanizmi sipas nr. Rendor 1. Eskavator, 4. Cilindra dhe 5. Rul ngjeshës (Viber pllakë).

Ndërsa kërkesë e AK ka qenë sipas DT – të plotësohet Aneksi nr.7 Paisjet dhe mekanizmi i obligueshëm.

Pasi që oferta juaj nuk ka qenë në harmoni me kërkesat e AK është shpallur e pa përgjegjshme.

Sipas pretendimit tuaj nr. V - AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk e ka aplikuar drejt kriterin e vlerësimit - **çmimi më i ulët**. Edhe pse ne kemi pasur çmimin më të ulët se OE i shpallur fitues AK nuk e respekton nenin 60 të LPP-së dhe kalon tek OE që kishte çmimin më të lartë se ne. Përpos kësaj AK ka zbatuar standarde të dyfishta gjatë vlerësimit të tenderëve sepse neve na atribuon mangësi që në fakt nuk ekzistojnë si dhe kanë mundur edhe të sqarohen ndërsa për OE shpallur fitues ia fsheh të gjitha të dhënat e tenderit edhe pse për shumicën prej tyre nuk kishte fare kërkesë për sekret afarist. Nga krejt kjo po shihet qartë se AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së me rastin e përzgjedhjes së OE që edhe e ka shpallur fitues *nuk qëndron për faktin se:*

Përgjigjia e AK lidhur me pretendim nr. V është se:

Pretendimi i juaj nuk qëndron pasi që Autoriteti Kontraktues (AK) – konstaton se ka vepruar dhe vlerësuar gjitha ofertat ka vepruarë në mënyrë transparente dhe harmoni me Nenin 60 të LPP-së.

Pretendimet e juaja se dyshoni se OE i rekomanduar që të shpërblehet me kontratë nuk i ka pasur të gjitha dëshmitë në rregull, AK ka konstatuar se kjo nuk qëndron pasi që ka vërtetuar se OE i rekomanduar që të shpërblehet me kontratë, ka ofruar ofertën e tij në përgjegjshme në harmoni me kërkesat e DT dhe Njoftimit për Kontratë të AK.

AK ka vepruar në harmoni me Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi - ka trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminime dhe ka vepruarë në mënyrë transparente.

Oferta e juaj është eliminuar sipas arsyeve e lartë cekura edhe në letrën standarte pasi që nuk ka qenë e përgjegjshme sipas kërkesave të DT dhe Njoftimit për Kontratë përkundër që keni paraqitur çmimin më të ultë.

Kriteri i dhënies së kontrtatës sipas DT dhe Njoftimit për Kontratë ka qenë: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Oferta e cila ka qenë e përgjegjshme dhe në harmoni me kërkesat e DT dhe Njoftimit për Kontratë është rekomanduar që të shpërblehet me kontratë sipas kriterit Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Sipas pretendimit tuaj nr. VI - AK ka shkelur 72 të LPP-së sepse nuk e ka zbatuar dispozitën e tillë për sqarim të tenderit tonë lidhur me paqartësitë që i ka pasur gjatë procesit të vlerësimit. AK ka mundur të na kërkoj sqarim lidhur me dëshmitë që i ka kontestuar sepse ky nen shumë qartë e tregon se në raste të tilla AK-të mundet ta bëjë një gjë të tillë. Ja si e përshkruan dispozita e tillë detyrimin e AK-së për sqarim të tenderuesve me qëllim të vlerësimit të drejtë të tyre:

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.
2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.
3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Nga kjo shihet hapur se AK nuk ka respektuar nenin 72 të LPP-së sepse dëshmitë që AK është thirrur kur na ka eliminuar neve janë dëshmi objektivist të verifikueshme. Sqarimi i tyre është edhe detyrim i AK-së me të vetmin qëllim shfrytëzimin e parasë publike në mënyrë efektive, efikase dhe në mënyrën më ekonomike të mundshme.

Sipas pretendimit tuaj nr. VII – Duke u bazuar në dëshmit dhe faktet që u cekën më lartë rezultojnë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka **qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashu, AK nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne jemi OE i përgjegjshëm me çmimin më të lirë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Prag.1 i nenit 7 të LPP-së, e parasheh qartë që:

“ Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente” .

Po ashtu ju si AK nuk keni pasur në konsiderat edhe Nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike,

burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Përgjigjia e AK lidhur me pretendimet nr. VI dhe VII është se:

Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 1 Qëllimi, Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi - ka trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminime dhe ka vepruarë në mënyrë transparente.

Neni 72 dhe nenin 59 të LPP-së, si dhe Pika 10 e Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik ka specifikuar shembujt se si të veprohet rreth sqarimeve të tenderit në procesin e vlerësimit të tendereve, në rastin konkret të ofertës tuaj nuk keni përmbushur kërkesat dhe nuk janë lejuar të kërkojnë informata sqaruese.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 59 të LPP-së, ka bërë ekzaminim, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, dhe sipas kritereve të përcaktuara në FDT dhe Njoftimin për kontratë në harmoni me Nenin 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës ka shpërblyer me kontratë publike operatorin ekonomik që ka dorëzuar: Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Shqipe Hoxha

Menaxhere e zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës.